

VENDIM
Nr. 699, datë 13.11.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 1095, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE THELBËSORE NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, pika 2, 37, pika 3, 50, pika 2, 54, pika 2, 84, pika 2, 91, pika 3, dhe 114, pika 2, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kërkesat thelbësore në fushën e aviacionit civil, që i bashkëlidhen vendimit nr. 1095, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) fjalia e parë, e pikës 2, të nenit 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për sa u përket zhurmës dhe shkarkimeve, avionët dhe motorët e tyre, helikat, pjesët dhe pajisjet e përcaktuara të tyre, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, të përfshira në ndryshimin 13, të vëllimit I, në ndryshimin 10, të vëllimit II, dhe në ndryshimin 1, të vëllimit III, të aneksit 16, të Konventës së Çikagos, të gjitha të zbatueshme nga 1 janari 2021.”;

b) në nenin 67 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. në titullin e nenit 67 hiqen fjalët “(ky nen do të zbatohet kur Shqipëria të jetë asociuar në EASA, sipas parashikimeve të marrëveshjes shumëpalëshe)”;

ii. pika 1, e këtij neni, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Certifikatat e lëshuara nga EASA-ja apo autoriteti kompetent i ndonjë shteti anëtar dhe deklaratat e bëra nga persona fizikë dhe juridikë, në përputhje me rregulloren e BE-së nr. 2018/1139, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, dhe me aktet zbatuese dhe të deleguara, të cilat janë miratuar në bazë të saj, do të jenë të vlefshme dhe të njohura nga Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar pa kërkesa apo vlerësime të mëtejshme.”;

iii. pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Për njohjet e bëra nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në bazë të këtij neni, për rastet e përmendura në pikat 2 dhe 3, Autoriteti i Aviacionit Civil ndërmerr masa për të vendosur procedura komunikimi të vazhdueshme me autoritetin kompetent mbikëqyrës të personit fizik ose juridik, në mënyrë që të përditësohet për statusin e certifikimit apo deklarimit.”;

c) në nenin 70 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

i. në titullin e nenit 70 hiqen fjalët “(ky nen do të zbatohet kur Shqipëria të jetë asociuar në EASA, sipas parashikimeve të marrëveshjes shumëpalëshe)”;

ii. pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

“5. Autoriteti i Aviacionit Civil reagon, pa vonesa të panevojshme, për një problem urgjent të sigurisë, brenda fushës së zbatimit të këtyre kërkesave thelbësore, duke përcaktuar masat korrigjuese, që duhet të ndërmerren nga personat fizikë dhe juridikë, në lidhje me të cilët vepron si autoriteti kompetent dhe duke i shpërndarë informacionet përkatëse këtyre personave, përfshirë direktivat ose rekomandimet, kur kjo është e nevojshme për të mbrojtur objektivat e përcaktuara në nenin 1, të këtyre kërkesave thelbësore. Autoriteti i Aviacionit Civil, gjithashtu, mund të nxjerrë

¹ Ky vendim është përafëruar plotësisht me rregulloren (BE) nr. 2021/1087, e datës 7 prill 2021, që ndryshon rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për sa i takon përditësimin të referencave në parashikimet e Konventës së Çikagos. Numri CELEX: C/2021/2102, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 236, datë 5.7.2021, faqe 1–2.

buletinin e sigurisë, që përmban informacione jo të detyrueshme ose rekomandime të adresuara personave të tjerë fizikë dhe juridikë, të përfshirë në aktivitetet e aviacionit.

6. Për raste, të cilat nuk rregullohen nga aktet e dala, në zbatim të këtij vendimi apo për rastet kur mund të cenohet siguria në operim (*safety*), Autoriteti i Aviacionit Civil mund të nxjerrë masa të detyrueshme për zbatim. Për rastet, të cilat nuk rregullohen nga aktet e dala, në zbatim të këtij vendimi, masat përkatëse do të jenë në fuqi deri në plotësimin e legjislacionit përkatës, por jo më shumë se 1 (një) vit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama